




Deklaratat e analizuara:

13 Deklarata të analizuara

(nga Deklarimi për Herë të Parë 2006
deri Periodik/Vjetor 2017)

Ndryshimi i pasurisë nga fillimi i deklarimit deri në vitin 2017

Ndryshimi i Pasurisë ndër Vite





Rritja e pasurisë bruto është 4.1 herë

+ 2,058,128 Lekë Rritja mesatare vjetore e pasurisë

Ndryshimi i pasurisë sipas kategorive



Vlera në Lekë

Likuiditete
në Bankë



Likuiditete
në Cash

Pasuritë e
Paluajtshme



Pasuritë e
Luajtshme

Të ardhurat familjare të krijuara gjatë periudhës deklaruese

Të Ardhurat 2006-2017	Shuma në Lekë	Raporti në %
Paga dhe shpërblime nga funksioni	21,294,617	72.1%
Të ardhura nga pagat e familjarëve	2,161,627	7.3%
Të ardhura nga aktiviteti privat i vajzës si notere	3,453,665	11.7%
Dhurata ne Cash	2,110,788	7.1%
Të ardhura nga interesat bankare	514,800	1.7%
Total	29,535,497	100%



Kontrolli Aritmetik dhe Logjik

Kontrolli Aritmetik dhe Logjik për 12 vite rezultoi:

Pa probleme.



Në deklarimin për herë të parë në vitin 2006, subjekti deklaroi vlerë cash në shumën 4,600,000 lekë, e cila shërben si burim për investimet në vitet e ardhshme.

Në vitin 2009 janë deklaruar të ardhura në formë dhurate me rastin e martesës së vajzës në shumën totale prej 15.300 Euro, por nuk deklarohet asnjë shpenzim për këtë rast.

Në të njëjtin vit vajza e subjektit deklaroi blerje apartamenti me vlerë totale 94.000 Euro, për të cilin në vitin 2009 ka paguar vetëm këstin e parë në shumën 40,000 euro me huanë e marrë nga kushëri.

Gjithashtu në vitin 2010, vajza i paguan këstin e dytë shoqërisë sipërmarrëse në shumën totale prej 54,000 euro me burim: 23,000 euro nga bashkëshorti (pa dhënë burimin e këtyre të ardhurave), 11,000 euro nga kursimet e saj dhe të babait/subjektit deklarues, dhe diferenca sërish me hua nga kushëri. Konkretisht huaja e dytë nga kushëri është 20.000 euro sipas kësaj përlllogaritje.

Huaja e marrë kushërit rezultoi të jetë 60,000 euro, ndaj të cilit nuk ka realizuar asnjë shlyerje deri me datë 31.12.2017.

Gjendja e akumuluar Cash referuar deklaramëve periodike deri me dt.31.12.2017 është 6,843,546 lekë.